

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Djetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 8.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35, në lidhje me llogaritjen e të ardhurave të investimeve dhe principet e rumbullakësimit të vlerave të mjeteve të pensioneve dhe për parashkrimin e kohës dhe mënyrës me anë të së cilës Kujdestari duhet ti raportojë këto vlera Trustit dhe/ose Fondit të Pensioneve dhe/ose, aty ku aplikohet, Siguruesi i Pensioneve.

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e mbajtur më 25 korrik 2002 përshtat si vijon:

Rregulla 6 mbi Mjetet e Pensioneve dhe Vlersimi i Mjeteve të Pensioneve

Neni 1 Sfera dhe Qëllimi i Rregullës

3.1 Sfera e Rregullës

Kjo rregull i adresohet Trustit të Pensioneve Kursyese të Kosovës (“Trustit”), Fondit Suplementar Punëdhënës të Pensioneve (“Fondi i Pensioneve”), Siguruesit të Pensioneve Individuale Suplementare (“Siguruesi i Pensioneve”) dhe Kujdestarit të mjeteve të pensioneve.

3.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo rregull definon atë që është përfshirë si pasuri e pensionit sipas dispozitave të Nenit 1 të Rregullores së Pensioneve dhe metodën dhe principet që do të zbatohen në caktimin e vlerave të mjeteve të pensioneve (vlersimi I mjeteve) si dhe mënyrën dhe afatin kohor për Kujdestarin që të parashtrij raportet e kërkuara në Trust, Fondin e Pensioneve, si dhe Siguruesve të Pensioneve dhe BPK-s.

Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimi

Të gjitha kushtet e shfrytëzuara në këtë rregull janë siq janë definuar dhe caktuar në rregulloren e Pensioneve dhe/ose siq janë definuar më pas në këtë Rregull.

“Portofoliot e aksioneve” përfshin aksionet e fondit të institucionit të korporatës, qoftë në formë të zakonshme, përgjithshëm, ose aksioneve të privileguara.

“Vlera e shitblerjes së favorshme” është shuma të cilën blersi i gatshëm i paguan shitësit të gatshëm, kur asnjera palë nuk vepron nën detyrim ose ndikime tjera nga jashtë, dhe që të dyja palët kanë njohuri të konsiderueshme të barabartë të fakteve dhe rrethanave që ndikojnë në transaksion dhe shitësi ka pasur kohë të mjaftueshme të ekspozojë subjektin e shitjes në treg.

“Entiteti i Pensionit” përfshin, përveq nëse konteksti tregon ndryshe, Trustin, Fondin e Pensionit dhe Siguruesin e Pensionit.

“Mjetet e Pensioneve” konsiston si vijon:

- a). mjetet që janë kategorizuar si pasuri investuese, dhe
- b). Mjetet që nuk janë kategorizuar si pasuri investuese përfshijnë si vijon:
 1. Parat e gatshme në dorë dhe transit;
 2. Kontributete pranueshme, jo më gjatë se 30 ditë pas afatit, vetëm nëse kontributet e tilla janë të përfshira në Llogarinë Individuale të pjesmarrësit;
 3. Prona jo-investuese e poseduar dhe në kontrollë aktuale dhe posedim të entitetit të pensionit i siguruar në pajtim me kushtet dhe rrethanat e parashkruara në këtë Rregull;
 4. Pajisjet dhe mobiljet e zyrës, duke përfshirë hardëare-in dhe softëare-in e kompjuterit të shfrytëzuar dhe poseduar prej entitetit të pensioneve me administrim përkatës dhe udhëheqje të programeve të tyre të pensioneve dhe rregullimeve.

“Prona jo-investuese” përfshinë pronat personale, të tundshme dhe të patundshme të siguruar nga entiteti i pensionit ndryshe nga pronat investuese.

“Pronat investuese” të referuara interesit në tokë dhe /ose ndërtesë, të pa zaptuara nga entiteti i pensionit ose entitetet e tij të bashkuara për qëllimet e tyre personale, dhe nëse lejohen si investime direkte në

pajtim me Nenin 10 të Rregullores së Pensionit ose ligjeve tjera të aplikueshme.

“Fondet ” përfshijnë portofoliot e aksioneve dhe investimet në borxhet dhe obligimet dhe të gjitha llojet e investimeve .

“ Fondet afat-shkurte përbëhen nga parat e gatshme, deponimet në bankë, certifikata e deponimeve, instrumentet e parave në treg dhe fonde të tjera që kanë datën e mbushjes së afatit prej një viti ose më pak se data e vlerësimit.

“Fondet afat-mesme” përfshin lidhjet qeveritare, lidhjet e korporatave, hipotekat, aksionet e privileguara me datë fikse të riblerjes, dhe fonde të tjera që nuk janë lehtë konvertibile në kesh dhe që kanë datën e përmbushjes më gjatë se një vit mirëpo më shkurtë se 5 vite prej datës së vlerësimit.

“Fondet afat-gjate” janë të gjitha fondet që nuk janë kategorizuar si Afat-shkurte ose Afat- mesme.

2.2 Ndarja e Mjeteve të Pensioneve

Entitetet e pensioneve që sigurojnë edhe Kontributet e Definuara edhe rregullimet e pensioneve me Përfitim të Definuar duhet të segregojnë mjetetë dhe investimet përkatse dhe kontabilitetin në mënyrë të tillë që mjetetë që i takojnë pjesmarrësve dhe përfituesve të Kontributeve të Definuar të jenë të ndara dhe të veqanta prej mjeteve që ndodhen nën skemën e pensioneve për Përfitim të Definuar. Nuk duhet të ketë bashk-përzierje të këtyre dy mjeteve të pensioneve në menagjmentin, investimin, kontabilitetin dhe ruajtjen e tyre.

Neni 3

Kushtet e Pronës Jo- Investuese si Pasuri e Pensioneve

3.1 Kufizimet e përgjithshme

Në lidhje me kufizimet specifike të përshkruara në nenin e ardhshëm, prona jo-investuese e mbajtur dhe e poseduar nga entiteti i pensionit duhet të përfshihet si pasuri e pensionit nëse sigurohet si:

- a.** Nga entiteti i pensionit në plotësim ose në llogari të huazimeve, hipotekave, pengimit si garanci pagese, denimit, ose borxheve të tjera në drejtim të aktiviteteve të tija investuese dhe/ose administrimit të programit të tij të pensionit ose rregullimeve.

- b) Nga dhurimi, testamenti ose trashëgimia në lidhje me zhvillimin e biznesit të tij të pensionit nëse dhurimi nuk imponon restriksione për dhënjën e mjeteve të tilla. Në rast se dhurimi imponon restriksione për dhënjën e pasurisë, data efektive e përvetsimit, për qëllimet e kësaj Rregulle është data kur restriksioni(et) i tillë nuk zbatohet më.

3.2 Kufizimet specifike

- a. Pasuria e patundshme e lejuar si pasuri e pensioneve sipas këtij Neni 3.1 (pronë jo-investuese) të kësaj Rregulle duhet të jepet brenda periodës prej dy (2) vitesh prej datës së përvetsimit.
- b. Pronat e tundshme dhe/ose mjetetë e patundshme të lejuara si prona të pensioneve sipas Neni 3.1 (prona jo-investuese) sipas kësaj Rregulle duhet të jepen brenda gjashtë (6) muajve prej ditës së përvetsimit.
- c. Zgjatja e kohës së dhënjes. BPK-ja mundë të zgjat kohën për dhënjën e pronës të parashkruar në nenin a). dhe b). më lartë për një periudë ose periodat e tilla plotësuese të definuara në aplikacionin e shkruar të entitetit të pensioneve duke u treguar të arsyeshme që shitja me forcë e pronës mund të jetë kundër interesit të mirë të pjesëmarrsve dhe përfituesve të pensioneve.
- d. Në pensionin me Dobi të Definuar, qdo pronë jo-investuese e mbajtur nga entiteti i pensionit më gjatë se koha e parashkruar në këtë Rregull nuk do të përfshihet si pasuri e pensionit.

Neni 4

Vlersimi i Pronave të Pensioneve

4.1 Llogaritja e të ardhurave të investimeve

Për të gjitha Pensionet e Kontributeve të Definuar, Kujdestari duhet të llogarit të ardhurat e investimeve të mjeteve të pensioneve që janë nën kujdestarin e tij në fund të qdo muaji kalendarik duke e krahasuar vlerën e grumbulluar të pronave të pensioneve prej muajve të mëhershëm me vlersimin momental mujor të mjeteve. Ndryshimi i dy vlerësimeve minus kontributi i pranuar gjat muajit paraqet të ardhurat e investimit për atë muaj. Shkalla e të ardhurave është përqindja që shuma e të ardhurave të investimit prodhon për shumën e pronave totale të pensioneve që janë nën përkujdesje. Trusti, Fondi i Pensionit ose Siguruesi i Pensionit duhet të pershtat këtë të ardhur të investimit duke bërë llogaritje të ngjajshme me pronat tjera të pensioneve që nuk janë përfshirë në llogaritjet e Kujdestarit në mënyrë që të arrij të të ardhurat totale e investimit përkatës për shpërndarje për atë muaj.

4.2 Principet dhe Direktivat në Rrumbullaksim (vlersimin) e Mjeteve të Pensioneve

Mjetet e pensioneve duhet të vlersohen në vlerat e tyre të realizueshme ose në vlerat e tregut sipas principeve dhe direktivave si vijojnë:

- a). Portofoliet e aksioneve duhet vlersuar në “vlerën e fundit të shitjes” së tyre të vlerësuar nga Bursa e Aksioneve në datën e tregëtis menjëher para datës së vlersimit. Aksionet e pavlersuara ku vlera e tregut të hapur nuk mundë të matet lehtë duhet vlersuar në vlerën e realizueshme neto.
- b) Fondet afat-shkurta, ndryshe nga faturat dhe dëftesat e qeverisë dhe trezorit, janë vlersuar në vlerën e realizueshme neto. Faturat dhe dëftesat e qeverisë dhe trezorit do të vlersohen në kohën e përvetësimit në vlerat e tyre të zbritura. Vlerësimet që pasojnë pas datës së përvetsimit duhet të bëhen në vlerat e amortizuara.
- c) Fondet afat-mesme dhe afat-gjate do të vlersohen në vlerën amortizuese. Qdo ngritje ose zbritje që rezulton në vlerën e këtyre fondeve është e amortizuar për fitim gjatë periodës që ka mbetur deri në mbushje të afatit.
- d) Fondet e përbashkëta ose aksionet “Uni-trust” ose intersi i pjesëmarrjes në fondet tjera investuese janë vlersuar duke u bazuar në Vlerat e tyre Neto të Mjeteve (NAV) të vlersuar më së fundi në datën e tregtis menjëherë para datës së vlersimit. Nëse vlersimet e aplikueshme NAV nuk janë në dispozicion këto lloje të investimeve do të vlersohen në vlerën neto të realizueshme.
- e) Fondet e blera në treg të lir (nëpërmes të “over the counter”, agjentëve tregtar dhe komisionerëve) janë vlersuar duke u bazuar në vlerat përkatëse të realizueshme në datën e vlerësimit duke llogaritur dhe njohjur ndryshimet e vlerave ndërmjet datës së tregtis dhe datës së setëlmentit.
- f) Pronat investuese do të vlerësohen duke u bazuar në qmimin e caktuar dhe referencat tjera të besueshme në tregun e hapur. Nëse këto baza të vlersimit nuk janë në dispozicion, pronat investuese do të vlersohen në mënyrën e parashkruar për vlersimin e pronave jo-investuese.
- g) Pronat jo-investuese do të vlersohen në qmimin e caktuar të vlerës së tyre të tregut të hapur sikur është caktuar nga vlersuesi i kualifikuar i pavarur, zbritje e vogël për shpenzimet e arsyeshme të shitjes. Të gjitha mjetet e patundshme do të vlersohen së paku një herë në vit. Vlersimet duhet të bëhen më shpesh aty ku kushtet e tregut indikojnë se vlerat bartëse të mjeteve janë materialisht ndryshe prej vlerave në tregun e lirë.

- h) Hipotekat dhe huazimet do të qmohen, duke mos e kaluar vlerën e tregut të hapur të fondeve të tyre kolaterale, në qmimin bartës pa provision për obligimet në vonesa.
- i) Nëse fondi është ose bëhet “a non-performing loan” vlera e fondeve të tilla nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e tyre e realizueshme neto .
- j) Blerjet “cum dividend” ose “cum interest” që përfshijnë aksionet e barabarta ose fondet duhet të vlersohen pa përfshirjen e dividendit ose interesit derisa këto komponente të hyrjes janë pranuar në të vërtetë.
- k) Kontributet që duhet të merren duhet të vlersohen në qmim. Asnjë vlerë nuk është caktuar për pranime të tilla që janë më gjatë se 30 ditë.
- l) Për mobiljet e zyrës dhe pajisjet nuk duhet të caktohet ndonjë vlerë.
- m) Në caktimin e vlerave të mjeteve të pensioneve, kamata dhe shkalla e zbritjes duhet të rumbullaksohen deri te ¼ më e afërm e 1%.
- n) Mjetet jo-investuese të pensioneve vlera e tregut të cilave nuk mundë të determinohet si duhet mundë të vlersohen në vlerën e realizueshme, nëse është në dispozicion. Nëse është ndryshe në përvetsimin dhe qmimin historic.
- o) BPK-ja mundë të lejoj baza tjera për vlerësim që mundë të jenë në pajtim me kërkesat e Organizatës së Kooperimit Ekonomik dhe Zhvillimit (OECD), Unionit Evropian dhe/ose standardet e formuluar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për vlerësimin e mjeteve të pensioneve.

Neni 5

Raportet që kërkohen prej Kujdestarit

5.1 Kujdestari i Mjeteve të Pensioneve dhe të Ardhurave të Investimeve

- a). **Raportet mujore.** Brenda 10 ditëve të para pas fundit të qdo muaji kalendarik, kujdestari duhet ti paraqes raportin mujor Trustit, Fondit të Pensioneve ose Siguruesit të Pensioneve, si aplikohet, listën e mjeteve të pensioneve nën kujdestarin e tij. Raporte të veqanta duhen bërë për mjetet e pensioneve të Kontributeve të Definuara dhe mjeteve të pensioneve me Përfitim të Definuar. Kujdestari duhet gjithashtu të paraqes kopjet e këtyre raporteve në BPK po të njëjtën ditë. Ky raport duhet të përmbaj informatat si vijojnë:

1. Paraqitja e gjitha mjeteve nën përkujdesjen e tij në fundë të qdo

muaji momental dhe të muajit para tij duke treguar vlerat përkatëse në pajtim me principet dhe direktivat e përshkruara sipas kësaj Rregulle.

2. Llogaritja e shkallës së të ardhurave të investimeve të mjeteve të pensioneve të Kontributeve të Definuara nën përkujdesjen e tij.

b). Raportet tjera. Kujdestari duhet të pregadit të gjitha raportet tjera që mundë të kërkohen sipas kushteve të Marrëveshjes së Kujdestarit me Trustin, Fondin e Pensionit dhe Siguruesin e Pensionit. Një kopje e raporteve të tilla gjithashtu duhet të sjellet në BPK në të njëjtën mënyrë dhe kohë.

c). Kujdestari duhet të sjell në BPK raportet e tilla dhe informatat mbi mjetet e pensioneve nën përkujdesjen e tij që mundë të kërkohen nga BPK-ja. Në këtë rast, BPK-ja duhet të specifikojë llojin e raportit dhe natyrën e informatës që kërkohet dhe duhet të përshkruaj mënyrën dhe kohën e paraqitjes së tyre.

Neni 6

Shpërndarja e të ardhurave të investimeve në Llogaritë Individuale të Pensioneve

6.1 Pensionet e kursimit

Trusti duhet të shpërndajë të ardhurat totale të investimeve të llogaritura në pajtim me Nenin 4.1 të kësaj Rregulle në Llogaritë Individuale të pjesëmarrësve në pensionet e kursimit. Shpërndarja duhet të bëhet në pajtim me metodat dhe procedurat e përshtatura nga Trusti i Pensioneve të Kursimit të Kosovës.

6.2 Për Pensionet Suplementare dhe/ose Vullnetare

a). I aplikueshëm për siguruesit e Pensioneve me Kontribut të Definuar. Të ardhurat totale të investimit të llogaritura në pajtim me Nenin 4.1 të kësaj Rregulle duhet të ju shpërndahen gjithë pjesëmarrësve në pajtim me metodat dhe procedurat e themeluara sipas dispozitave të Urdhërësive të Pensionit ose Rregullave të Pensionit, si e aplikueshme.

b). I aplikueshëm për siguruesit e Pensioneve me Dobi të Definuar. Format e të ardhurave totale të investimeve pjesë e mjeteve të segreguara të mjeteve të pensioneve të shfytëzuara për financim të dispozitave teknike të kërkuara sipas kësaj Rregulle për siguruesit e rregullimeve të Pensioneve më Dobi të Definuar.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyj në fuqi më 25 korrik 2002.

Drejtori i Përgjithshëm